

ku behet bashkimi i dy kolektoreve $\Phi 1000$ mm ai i rruges "Mujo Ulqinaku " dhe ai i Pedonales "Jakov xoxa ".Ne projekte eshte parashikuar qe kolektori do te realizohet me tubo te brinjezuar HDPE DN 1000 mm gjate gjithe gjatesise deri ne bashkimin me kolektorin ekzistues $\Phi 2000$ mm ne rrethe rrotullimin prane ura sheq (Ne kryqezimin e rruges "Skenderbeu" me rrugen "Jakov Xoxe".Ne kete kolektore eshte largimi i te gjitha ujrave te zeza qe vine nga pallatet dhe objektet ekzistuese ne te dyja anet e rruges ku do te behet bashkimi me tubo te brinjezuar $\Phi 250$ mm .Te gjitha pusetat e vjetera do te behen te reja me b/arme dhe me kapak gize .

Kolektori ka nje gjatesi prej 442 metera, ku te gjitha pusetat ekzistuese te ujrave te rruges te cilat do te derdhen ne kete kolektore do te behen te reja dhe me sinfon per eleminimin e ererave qe dalin nga kuz.

Krahu i majte aktualisht ka nje prurje me te madhe shkarkuese, ku vlen te permenden si pika kryesore, objekte 8-10 kateshe ne dhe shtepi banimi deri ne 3-4 kate qe ndodhen ne vazhdim. Kuota e shkarkimit momentalisht eshte ne thellesine 1.3 m prej terrenit ekzistues..

Profili gjatesor i tij eshte i paraqitur ne vizatime me elementet perkatese te nevojshme per zbatimin e tij. Gjithashtu eshte parashikuar gjurma e tij ne planimetrine e pergjithshme. Aksi i tij shkone pergjate aksit rruges, por gjithmone nuk duhet te afrohet me shume se 120 cm nga bordura e rruges te cilat nuk duhet te demtohen gjate zbatimit te punimeve. Ai eshte i pajisur me puseta kontrolli b/a me diameter 1.5 m dhe me thellesi 3.5-4.5 m. Jane te pajisura me konike qe perfundojne me mbulim kapak gize. Te gjitha keto puseta jane te paraqitura ne planimetri. Per hollesi te metejshme te shihen vizatimet.Kanalet qe do te hapen jan parashikuar trapezoidale me thellesi deri ne 4.5 m dhe te gjere fundore 1.6 m dhe ne fillim me gjersi 2.4m . Nivelimi do te behet me cakull te forte(te trashe) dhe me zhavorr te imet. Sygjerohet nje mbushje deri ne 2 metra mbi tub mbasi kolektori kalon ne rrugen automobiliste ku ne te kalojne mjete me kapacitet te larte tonazhi.

Ne vendet ku dherat jane te paqendrueshem keshillohen te merren masat per rreshqitjen e dherave. Kanalet do te nivelohen ne taban me mbushje zhavorri dhe rere qe do te mundesojne mbrojtjen e tubit dhe nivelimin e mir te tij Mbi kuoten e mbushjes se tubit eshte. Mbushja me dhe keshillohet qe duhet te ngjishet me shtresa afersisht 30 cm qe te shmangen uljet e konsiderueshme te shtresave te sistemit. Per shkarkimin e ujrave te

zeza te ndertesave afer kolektorit do behet e mundur me tub te brinjeuar $\Phi 250$ mm i cili do lidhet me kolektorin kryesor nepermjet pusetave qe kemi parashikuar.

- **Ndertimi i kanalizimeve te Ujerave atmosferike.**

Ne krahun e majte te rruges eshte parashikuar ndertimi i kanalizimeve te ujerave te bardha. Ky sistem eshte i perbere nga puseta shiu b/a 40 me 60 cm te cilat do te lidhen me njera tjetren nepermjet tubave me $d= 200$ mmi brinjezuar. Pusetat qe do te beje shkarkimin e ujerave atmosferike ne pusetat qendrore do te pajiset me sifon. Tubat e shkarkimit te ujerave atmosferik do te kene nje pjerrresi prej 2 % ne trotuare. Vendosja e tyre eshte parashikuar te behet sipas planimetrise ekzistuse dhe ne vendet ku kane qene ekzistuset mbasi atje lidhen me tubot ekzistues. Ne kete kolektore do te behen edhe pusetat e shiut. Kanali i pusetave te shiut do te jete me nje thellesi deri ne 1 m dhe me nje gjeresi 50 cm me sinfon (Tsh2).

Punoi : Ing.Haxhi Avdullai



The image shows a handwritten signature in blue ink over a circular official stamp. The stamp contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top, 'BAJTI' in the center, and 'SEKRETARIA BASHKIA FIER' at the bottom.